




REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. DPK	Nr. Prot. 03-02/4247/18
Nr. ftoje 02	Data 30.11.2018
Nr. pages	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të të Rregullores nr. 01/2018 Për Ndryshimin Dhe Plotësimin e Rregullores Nr.01/2014 dhe Rregullores Nr.01/2017 Të Punës Së Agjencisë Kundër Korrupsionit me datë 29.11.2018, mori:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-1488/18, për zyrtarin e lartë z.Sulltan Badalli, Anëtar i Kuvendit Komunal të Prizrenit, dhe Anëtar i Bordit të Drejtorëve në KRM-Eco-Regjioni Sh.A, Prizren, për shkak se zyrtari i lartë publik është shkarkuar nga funksioni si Anëtar i Bordit të Drejtorëve në KRM-Eco-Regjioni Sh. A-Prizren, andaj më ketë është shmangur edhe gjendja e mundshme e konfliktit të Interesit dhe papajtueshmërisë në ushtrim të funksionit publik .**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-02-1488/18, qe për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Sulltan Badalli, Anëtar i Kuvendit Komunal të Prizrenit, dhe Anëtar i Bordit të Drejtorëve në KRM-Eco-Regjioni Sh.A, Prizren.

Ky rast ka filluar të trajtohet pasi qe është vërejtur se zyrtari i lartë z. Sulltan Badalli, si Anëtar i Kuvendit Komunal të Prizrenit, ushtron edhe funksionin e Anëtar të Bordit të Drejtorëve në Kompanin Rajonale të Mbeturinave –Eco Regjioni Sh.A- Prizren.

Agjencia kundër Korrupsionit sipas procedurave të parapara e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresë zyrtare se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet qe posedon Agjencia.

Pas kësaj shkrese z. Sulltan Badalli, ka kontaktuar me zyrtarët e AKK-së, dhe është interesuar për një takim për tu informuar për situatën që është iniciuar .



Zyrtaret e Agjencisë Kundër Korrupsionit kanë shfrytëzuar kërkesën e zyrtarit z. Badalli, dhe kanë organizuar në zyrat e AKK-së një takim me të, dhe e kanë njoftuar me faktet që posedon Agjencia lidhur me rastin e iniciuar për të.

Ne këtë takim zyrtari i lartë z. Sulltan Badalli, pasi është informuar me faktet e prezantuara, ka deklaruar se nuk është i informuar se mundë të ketë ndonjë kufizim ose papajtueshmëri në ushtrimin e këtyre funksioneve, duke theksuar se si anëtar Bordit të Drejtorëve në KRM-Eco-Regjioni Sh. A-Prizren, është emëruar si i deleguar nga Kryetari i Komunës së Prizrenit, por është zotuar se nëse konstatohet se ushtrimi i këtyre funksioneve është në papajtueshmëri ose ka ndonjë kufizim aji është i gatshëm që ta respektoj çdo vendim të Agjencisë Kundër Korrupsionit.

Agjencia kundër Korrupsionit duke pas parasysh se zyrtari lartë z. Sulltan Badalli, nuk ka ndërmarr asnjë veprim i ka dërguar edhe shkresën e dytë paralajmëruese dhe e ka njoftuar për veprimet që duhet të ndërmer për evitimin e Konfliktit të Interesit dhe papajtueshmërisë në ushtrim të funksionit publik.

Pas këtyre veprimeve zyrtari i lartë z. Sulltan Badalli, na ka njoftuar se ka pranuar shkresën paralajmëruese nga AKK-ja dhe na ka njoftuar se Komisioni i Aksionareve i Komunës së Prizrenit e ka shkarkuar nga funksioni si anëtar i Bordit të Drejtorëve në KRM-Eco-Regjioni Sh.A, Prizren.

Për ta vërtetuar informacionin e pranuar nga zyrtari i lartë kemi kërkuar edhe dokumentin zyrtar nga, KRM-Eco-Regjioni Sh.A, ku jemi njoftuar se zyrtari i Sulltan Badalli, është shkarkuar nga komisioni i aksionareve andaj i njëjti nuk është duke e ushtruar funksionin si anëtar i Bordit të Drejtorëve në KRM-Eco-Regjioni Sh.A, Prizren.

Duke vlerësuar gjendjen reale si dhe duke u bazuar në informacionet e pranuar nga Kompania Regjionale e Mbeturinave Eco-Regjioni Sh.A, Prizren, shihet se janë krijuar rrethana të reja pasi që zyrtari i lartë është shkarkuar nga funksioni si anëtar i Bordit të Drejtorëve në KRM-Eco-Regjioni Sh.A, Prizren, andaj duke marr parasysh këto fakte konstatojmë se është shmangur gjendjen e konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë, z. Sulltan Badalli, Anëtar i Kuvendit Komunal të Prizrenit andaj dhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

